

Të nderuar kolegë,

Është folur shumë sot për këtë paketë fiskale dhe këtë projektbuxhet që qeveria kërkon të miratojë sot, i cili është një shembull i paparë i shfrytëzimit të çdo mundësie për ta shpënë drejt dorëzimit biznesin, qytetarët, shoqërinë në tërësi, por në veçanti bujqësinë, investimet vendase, kryesisht prodhuesit vendas. Paketat fiskale janë shumë të nxituara, të padiskutuara dhe të padialoguara me faktorët e interesit, me agrobiznesin dhe industrinë e prodhimit, të cilët luajnë një rol kyç në ekonominë e vendit dhe, pa dyshim, mbulojnë zëra të rëndësishëm në buxhetin e shtetit. Konsultimin e këtij buxheti historik po e shikoni sot në Lushnjë. Biznesi vendas, industria prodhuese dhe bujqësia në Shqipëri kanë hasur problematika të shumta gjatë këtyre viteve të fundit, të shkaktuara nga pandemia, të cilat, me hapjen e tregjeve dhe lëvizjen e mallrave dhe shërbimeve, treguan që efektet e izolimit qenë të paevitueshme. Filloi rritja e paparashikueshme e çmimeve të lëndëve të para, që u pasua me karburantet dhe, së fundi, po jep efektet e saj edhe rritja e energjisë. Në këtë valë të pandalshme të problematikave të përmendura më lart, sektori i bujqësisë, sidomos ai i industrisë prodhuese, kanë si domosdoshmëri stimuj fiskalë për të lehtësuar dhe për të ndihmuar rimëkëmbjen e biznesit nga krizat e njëpasnjëshme ekonomike, por e kundërta po ndodh, sepse, siç tha edhe zoti Rushaj, pandemia dhe tërmeti funksionojnë vetëm për qeverinë.

Zbatimi i shkallës së taksimit me akcizë 6 lekë/litri për gazin e lëngshëm për shfrytëzim industrial apo konsum familjar, sepse këta nuk kontrollojnë dot territorin, rëndon kostot e familjeve dhe, mbi të gjitha, koston e buxhetit, të atyre që janë taksapaguesit kryesorë dhe që mbajnë ekonominë e këtij vendi. Duhet të kuptojmë që ka biznese në Shqipëri që konsumon çdo ditë mesatarisht 10- 15 mijë litra gaz të lëngshëm me një kosto mesatare vjetore që mund të shkojë 180-240 mijë euro në vit. Një kosto shumë e lartë që i vendos këto kompani përpara përgjegjësisë të reduktojnë prodhimin apo edhe të pezullojnë plotësisht veprimtarinë e tyre. E njëjta mendësi, por edhe më keq akoma, është përdorur për heqjen e rimbursimit për lëndët djegëse për konsum të brendshëm gjatë procesit teknologjik për prodhime të tjera në industrinë vendase. Do të doja ta bëja më të prekshme këtë, duke dhënë një shembull.

Cilado industri vendase që përdor lëndën e parë, të cilën është e detyruar ta ngrohë, përdor lëndë djegëse për ta çuar në temperaturën e nevojshme të procesit teknologjik. Kjo do të thotë se kjo lëndë djegëse përveçse kushton, ngarkohet edhe me barrë fiskale/akcizë (sidoqoftë lëndë djegëse e ngurtë apo e lëngët, ngarkohet me barrë fiskale), e cila zë afërsisht 1/3-ën e koston së prodhimit, ndryshe nga industrinë dhe bizneset e ngjashme në rajon dhe Europë, të cilat, në bazë të direktivave të Komitetit Europian, rimbursohen për këtë konsum të brendshëm, nuk e paguajnë fare madje. Ky është një rekomandim i FMN-së. Unë do të doja të lexoja vetëm direktivën e Komitetit Europian, e cila është pasqyruar në legjislacionin tonë, ku nuk lejohet që të taksohet konsumi i brendshëm. Direktiva nr. 203/96 e Këshillit të Europës, e cila është transpozuar në legjislacionin shqiptar, por edhe në të gjitha legjislacionet europiane dhe ato të rajonit: “Për produktet energjetike të përdorura për konsum të brendshëm në industri apo në proceset mineralogjike parashikohet përjashtim nga pagesa e akcizës”. Këta justifikohen se është vetëm një prej bizneseve, por harrojnë që ato janë degë të plota të industrisë. Një industri e rëndësishme është edhe industria e naftës.

Siç tha sot edhe Kryeministri, në qoftë se kanë ndërmend të vënë në punë rafinerinë e Ballshit me këtë konsum të brendshëm, ta harrojnë se mund ta vënë më punë. Vetëm rafineria e Ballshit konsumon 166- 170 tonë lëndë djegëse në ditë, që i bie rreth 5 mijë tonë në muaj, përkthyer në ngarkesë fiskale, akcizë e paguar rreth 2 milionë lekë në vit. Akoma më cinike është rritja e pragut të përjashtimit për investimet në makineri e pajisje nga 50 milionë në 500 milionë lekë, me argumentin për të promovuar investitorët strategjikë. Le të bëjmë një krahasim. Për t'u klasifikuar si biznes VIP në Shqipëri, mjafton të kesh një nga kushtet për një xhiro prej 250 milionë lekësh të rinj në vit, që nuk është kushti i vetëm, por është një nga kushtet e saj. Një biznes që ka një xhiro 250 milionë lekë në vit apo 500 milionë, a ka mundësi të blejë makineri e pajisje me vlerë 500 milionë lekë që të përfitojë rimbursimin? Justifikimi i kësaj është që ne incentivojmë investitorët strategjikë, të cilët tashmë janë të incentivuar me ligjin e investitorëve strategjikë të miratuar në vitin 2016. Dyshoj se ky është një gjykim jashtë sistemit, por e sigurt është se metodologjia e përjashtimit krijon pasoja në rritjen e investimeve nga subjektet, ul punësimin, mbështet grupe të caktuara monopolistësh e monopolesh pranë pushtetit.

Struktura e investimeve mbi këtë parim nxit klientelizmin e gjithfarë kualitetesh që ndjellin njëri-tjetrin, absolutisht nën hijen e me hirin e pushtetit. Prirja për zgjidhje të thjeshta, ku të mbushim gropën, por jo dinamike, të papërpunuara në strukturën e tyre, lidhet me sa duket, me përparësitë politike të momentit, me dobi të dyshimta dhe me përfitues gjithnjë pranë pushtetit. Funkcionalizmi i masave në një model të qartë është i pamundur, kur qëllimi politik është pushteti, madje pushteti i thjeshtë, me pak duar ndërmjetësh, por me çdo kusht. Në këtë mënyrë, në kontekstin e buxhetit, nuk ka aspak vlerë apo interes çështja e pensioneve, të cilat nuk rriten fare, vetëm indeksohen; rritja katastrofike e borxhit publik; arratia e njerëzve, e cila sqaron propagandën për uljen e papunësisë, sepse nuk ka më shqiptarë; shpërfillja e plotë e mendimeve apo nevojave të grupeve të interesit. Revokimi edhe i ndonjë mase të arsyeshme, për shembull, kompensimi i TVSH-së në masën 6% për fermerët është i pakuptueshëm pragmatikisht, pasi do të sjellë rënien e interesit për formalizimin e tyre. Në këtë hulli shkon edhe niveli shumë i ulët i subvencioneve në bujqësi. Blegtoria është rrënuar dhe nuk ka akademi ta nxjerrë nga halli këtë vend. Po ju marr shembull Kaninën në Vlorë, ku ka pasur disa ferma të mëdha blegtorale, me bagëti të imta e të trasha. Këto ferma tashmë janë shkatërruar gjatë këtyre 8 viteve dhe nuk kanë pasur asnjë mbështetje nga shteti. Ishin mbi 20 fermerë që kanë pasur stane me lopë dhe me bagëti të imta në malin e Kaninës, sot ato nuk janë më. Këta fermerë kanë qenë të regjistruar me nr. NIPT-i, me siguracione të paguara dhe asnjëherë nuk kanë marrë subvencione, sepse harta e subvencionimit përgatitet në shtabet elektorale të "Rilindjes".

Të nderuar kolegë,

Tek e fundit, buxheti do të materializohet në vepra, në shërbime, prognoza për të cilat parashikimi është me të vërtetë i zyrtë. Në Vlorë, për shembull, propaganda për furnizimin me ujë 16 orë në ditë në vitin 2024, kur në dijeninë time, në fshatrat e Vlorës sot nuk ka as 1 orë furnizim me ujë. Këtë mesataren 13 orë të furnizimit me ujë për vitin 2021 nuk e di nga e keni nxjerrë! Ne nuk jemi kundër partneritetit publikprivat, por jemi kundër abuzimit me to. Me lejoni t'ju jap një shembull. Në zonën e Vlorës janë duke u bërë dy investime infrastrukturore që kanë lidhje me njëri-tjetrin, gjerdani infrastrukturor i Jugut. I pari është bajpasi i Vlorës, një investim i Komitetit European, i konkluduar në vitin 2011, gjatësia 29 kilometra, e gjitha trase e re, kalon në një terren të vështirë, me minimumi 5 vepra arti, 5 ura, dhe me një kosto totale, pas peripecive të shumta të saj, që mbërrin në 53 milionë euro, pra me një mesatare prej 1,8 milionë eurosh për kilometër. Aty ku mbaron ky bajpas fillon kontrata koncesionare për ndërtimin e rrugës Orikum – Porti i Jahteve – Dukat – Ura e Shën Elizës me një gjatësi totale prej 14,7 kilometrash, përgjithësisht trase ekzistuese, dhe vetëm ndërtimi i saj kushton në të njëjtën vlerë me këtë që është dyfishi i gjatësisë. Pra, kemi dy rrugë, njëra 30 kilometra, tjetra gati 15 kilometra që kushtojnë të dyja njësoj, janë e njëjta kategori. Kjo që është më e gjatë,

është e gjitha trase e re, kurse tjetra është trase ekzistuese dhe devijohet vetëm atje ku ka shkarë rruga në Dukat, në qoftë se ju ka rastisur të kaloni në Llogora, pa menduar këtu interesat që do t'i paguhen parterit privat në këtë rast për ndërtimin e rrugës, që janë edhe rreth 30 milionë lekë të tjera. Në total kjo rrugë do t'u kushtojë shqiptarëve 99 miliardë lekë, ose gati 100 milionë dollarë. Ky është një buxhet barqesh, pak barqesh, dhe akoma me pak duarsh, por fjalë do të ketë shumë, si gjithmonë! Do të ketë projekte iluministe, punë të përmasave globale, arritje kozmike e të tjera, çka krijon premisën e një akti politik në traditën e lashtë propagandistike të punizmit. Do të ketë fitore dhe zhvillim, për xhepat e tyre, pa dyshim! Si gjithmonë, të humbur do të jenë qytetarët shqiptarë! Ju faleminderit!